



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA Durrës
DREJTORIA LIGJORE
SEKTORI JURIDIK**

PROJEKT –VENDIM

NR____, DATË__/__/2025

**PËR
MIRATIMIN E UDHËZUESIT PËR MËNYRËN E APLIKIMIT “PËR
IMPLEMENTIMIN E SKEMËS: GRANTE PËR TË RINJTË NË
MBËSHTETJE TË ZHVILLIMIT TË INICIATIVAVE
EKONOMIKE LOKALE”**

Në zbatim të Ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, Ligjit Nr. 9374, datë 21.04.2005 “Për Ndihmën Shtetërore” i ndryshuar, Ligjit Nr. 36/2023 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 25/2022, “Për mbështetjen dhe Zhvillimin e Startup-eve”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.605, datë 31.08.2016 “Për përcaktimin e vlerës maksimale, të kushteve dhe të procedurës për dhënien e ndihmës “de minimis”, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 115, datë 24/12/2024 “Për miratimin buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2025 dhe Programin Buxhetor Afatmesëm 2025-2027”, shkresës së Ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Drejtorisë së Përgjithshme të Nxitjes së Biznesit nr.7875 prot., datë 12.06.2025, protokolluar me tonën nr. 1975/2 prot., datë 16.06.2025 si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Turizmit, Kryetari i bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak Durrës të shqyrtojë në përputhje me aktet ligjore dhe,

TË VENDOSË:

1. Miratimin e Udhëzuesit për mënyrën e aplikimit “Për implementimin e skemës: Grante për të rinjtë në mbështetje të zhvillimit të iniciativave ekonomike lokale”.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Turizmit, Bashkia Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës.


DREJTORIA LIGJORE

Drejtore
Alneida Rroshi




DREJTORIA E TURIZIMIT

Drejtore
Lorenc Smajli



KRYETAR I BASHKISË

Emiriana Sako





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA Durrës
DREJTORIA E TURIZMIT**

Nr. _____ Prot.

Durrës, më _____. _____. 2025

RELACION

**PËR MIRATIMIN E UDHËZUESIT I APLIKIMIT “PËR IMPLEMENTIMIN E
SKEMËS: GRANTE PËR TË RINJTË NË MBËSHTETJE TË ZHVILLIMIT TË
INICIATIVAVE EKONOMIKE LOKALE”**

Në zbatim të Ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 9374, datë 21.04.2005 “Për Ndhimën Shtetërore”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 36/2023 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 25/2022, “Për mbështetjen dhe Zhvillimin e Startup-eve”, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 115 datë 24/12/2024 “Për miratimin buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2025 dhe Programin Buxhetor Afatmesëm 2025-2027” dhe në mbështetje të zhvillimit të iniciativave ekonomike lokale, Drejtoria e Turizmit ka parashikuar buxhetin e dedikuar për implementimin e skemës: grante për të rinjtë në mbështetje të zhvillimit të iniciativave ekonomike lokale.

Në këtë kuadër, Drejtoria e Turizmit ka parashikuar krijimin e një skeme financiare, për zhvillimin dhe fuqizimin ekonomik të të rinjve të qytetit të Durrësit. Kjo skemë financimi është në zbatim të funksioneve dhe kompetencave të veta të Bashkisë Durrës, të përcaktuara në nenin 28 pika 6, nenit 54 pika k, të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; ligjit Nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 115 “Për miratimin buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2025 dhe Programin Buxhetor Afatmesëm 2025-2027” dhe Shkresës së Komisionit të Ndhimës Shtetërore Nr. 7875 prot, datë 12.06.2025 me objekt: “Komunikohet vendimi i Komisionit të Ndhimës Shtetërore” administruar në Bashkinë Durrës me nr.1975/2, datë 16.06.2025” (shkresa bashkëlidhur).

Sipas Vendimit Nr. 126, datë 12/06/2025, Komisioni i Ndhimës Shtetërore, vendosi të miratojë skemën e ndihmës shtetërore në formën e grantit “Grante për të rinjtë në mbështetje të zhvillimit të iniciativave ekonomike lokale”.

Referuar Vendimit të Komisionit të Ndhmës Shtetërore, Nr. 126, datë 12/06/2025, plani i ndihmës i miratuar në buxhetin e Bashkisë Durrës financohet nga buxheti i miratuar për Bashkinë Durrës nëpërmjet instrumentit të grantit për të rinjtë me ide biznesi në një vlerë të caktuar nga dhënësi i ndihmës. Nëpërmjet transferimit të burimeve shtetërore në formën e grantit të drejtëpërdrejtë, Bashkia Durrës i ofron të rinjve sipërmarrës/përfituesve një avantazh duke i lehtësuar mbi mbulimin e shpenzimeve që normalisht do të duhet të përballonin me fonde të veta përgjatë aktivitetit ekonomik.

Kjo skemë e granteve për të rinjtë do të zbatohet nëpërmjet procedurës së aplikimeve me shprehje interesi, si një mundësi e re ekonomike për të rinjtë sipërmarrës aspirantë për të qenë të qëndrueshëm në një treg konkurses. Ndihma jepet vetëm për të rinjtë që do të jenë fitues nga procesi i përzgjedhjes së aplikantëve me idetë më të mira dhe garantojnë qëndrueshmërinë e biznesit.

Qëllimi i kësaj thirrje është të mbështesë plane të qëndrueshme biznesi të ideuara nga të rinjtë e qytetit të Durrësit, për krijimin e bizneseve të reja ose zgjerimin e aktivitetit të bizneseve ekzistuese. Procesi i përzgjedhjes së aplikantëve ka si qëllim të ofrojë transparencë dhe konkurrencë të barabartë si dhe të mbështesë idetë dhe planet e biznesit më të mira, inovative, fitimprurëse dhe që garantojnë rezultate të qëndrueshme. Skema do të zbatohet në të gjithë territorin e Bashkisë Durrës.

Nëpërmjet implementimit të kësaj skeme për të rinjtë, synohet të promovojmë një model të qëndrueshëm të zhvillimit ekonomik, miqësor ndaj mjedisit si edhe një qasje alternative dhe inovatore ndaj trashëgimisë kulturore. Inovacioni apo risia konsiston në zbatimin e një produkti të ri, përmirësimin e ndjeshëm të shërbimeve ose proceseve, krijimin e një metode të re marketingu apo një metode të re organizative në praktikën e biznesit, me kushtin që veprimtaritë e propozuara të kenë një qasje miqësore ndaj mjedisit.

Kjo nismë e propozuar nga Drejtoria e Turizmit, për shqyrtim dhe miratim në Këshillin Bashkiak, ka për qëllim të promovojë një model të qëndrueshëm dhe transparent, të orientuar drejt zhvillimit ekonomik dhe të bazuar në projekte për financimin e individëve të rinj që kanë një ide për krijimin e një aktiviteti të ri ekonomik apo që kanë një biznes ekzistues të vogël ose të mesëm dhe janë të regjistruar në Bashkinë Durrës. Referuar VKB-së Nr. 115, datë 24/12/2024, fondi total i Skemës së Granteve për të Rinjtë është në vlerën 4.000.000 lekë, dhe financohet plotësisht nga Bashkia Durrës.

Granti do të mbështesë të rinjtë e moshës 18-30 vjeç, banues në Bashkinë Durrës të cilët kanë një ide për krijimin e një biznesi të ri apo që kanë një biznes ekzistues të vogël ose të mesëm dhe kërkojnë të shndërrohen në biznese në fushën e Mjedisit dhe të Trashëgimisë Kulturore, për një projekt propozim me afat nga 6 - 12 muaj dhe shuma do shpërndahet në

bazë të planit financiar të aplikimeve fituese.

Alokimi i skemës së Grantit për të rinjtë do të bazohet në Udhëzuesin Operacional “Për implementimin e skemës: Grante për të rinjtë në mbështetje të zhvillimit të iniciativave ekonomike lokale”, të hartuar nga Drejtoria e Turizmit (Udhëzuesi bashkëlidhur). Ky Udhëzues përfshin të gjitha procedurat dhe dokumentacionin e detajuar të nevojshëm për të zbatuar në profesionale dhe transparente skemën e grantit për të rinjtë.

Referuar Udhëzuesit të Aplikimit:

- Skema e grantit mbulon 100% të shpenzimeve të pranueshme brenda limitit të sipërpërmendur;
- Grantet e alokuara në këtë thirrje mund të mbulojnë shpenzimet e personelit deri në masën 20% të shumës së kërkuar. Ndërsa, 80% e totalit të grantit duhet të shpenzohen për aktivitetet e përfituesit, nga të cilat deri në 10% e kësaj shume mund të përdoret për qëllime reklamash.

Efektet financiare për zbatimin e këtij aktiviteti do të mbulohen nga buxheti i miratuar për Bashkinë Durrës sipas VKB-së Nr. 115, datë 24/12/2025, programi 04130 “Mbështetje për Zhvillimin Ekonomik”, zëri “grante për të rinjtë në mbështetje të zhvillimit të iniciativave ekonomike lokale”.

Referuar Udhëzuesit, Bashkia Durrës do të krijojë dhe fuqizojë mekanizmat monitorues të aktiviteteve dhe rezultateve të projekteve që do të zbatohen nga bizneset e shpallura fituese. Njëkohësisht përveç mbështetjes financiare, Bashkia Durrës do të zbatojë një program aftësimi i cili do të përfshijë dhënien e asistencës teknike dhe trajnimeve për zhvillimin e kapaciteteve të tyre.

Por, vlen të theksohet, se Bashkia Durrës ka të drejtën që të mos shpërndajë të gjitha fondet e miratuara në dispozicion, në rastet kur projekt-propozimet fituese nuk i përmbushin kriteret e kërkuara sipas Udhëzuesit të Aplikimit.

DREJTOR
Lorenc Smajli

